

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5836
E enjte, 25 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Policia arreston 18 persona për trafikim të armëve dhe municioneve



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFAQËSUESIT E TË GJITHA SUBJEKTEVE POLITIKE JANË SHPREHUR TË
GATSHËM PËR ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME ■FAQE 4 - 5

Partitë presin presidentin për t'i nisur konsultat për datën e zgjedhjeve



Subjektet politike të pozitës dhe të opozitës janë në pritje të lëvizjes së presidentit Hashim Thaçi për t'i filluar konsultat rreth caktimit të datës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, përfaqësuesit e partive politike janë

shprehur të gatshëm që t'u drejtohen kutive të votimit. Ata i kanë bërë thirrje presidentit të vendit, Hashim Thaçit, që të mos bëjë vonesa të panevojshme për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. Ndërkaq presidenti Thaçi ende nuk ka bërë asnjë lëvizje në këtë drejtim

RAMUSH HARADINAJ DHE JAKUP KRASNIQI JANË PARAQITUR TË MËRKURËN PARA
GJYKATËS SPECIALE E CILA VEPRON NË HAGË

Haradinaj dhe Krasniqi intervistohen nga Specialja, mbrohen në heshtje

Ramush Haradinaj dhe Jakup Krasniqi janë mbrojtur në heshtje të mërkurën gjatë intervistimit nga Prokuroria Speciale e Dhomave të Posaçme në Hagë. Ish-komandanti i UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit dhe ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së kanë deklaruar për media se me këtë veprim kanë kryer obligimet ligjore ■FAQE 3



AKTUALE



**BORIS JOHNSONI MERR
DETYRËN E KRYEMINISTRIT
TË BRITANISË F. 2**

**GJYKATA E TIRANËS
KONFIRMON MANDATIN E
DYTË TË ERION VELIAJT F. 2**

**NË MAQEDONINË E VERIUT
ARRESTOHET ISH-PJESËTARI I
UÇK-së F. 7**

EKONOMI



**NGA TAKSA 100 PËR QIND
KOSOVA KA PËRFITUAR
7 MILIONË EURO F. 9**

**MINISTRIA E DIASPORËS
HAP PANAIRIN TRADICIONAL
TË DIASPORËS F. 9**

SPORT

**AZEMI: KOSOVA KA SHANSE
PËR KUALIFIKIM F. 12**

**KUKA: SHTETI NUK
PREZANTOHET ME SHËTITJE
DHE FOTOGRAFI F. 12**

**Vazhdimi i dialogut, i ndërlidhur me
formimin e qeverisë së re** ■FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Han dhe Riker në Shkup, takime me krerët shtetërorë dhe opozitën

SHKUP, 24 KORRIK - Komisari evropian i Zgjerimit, Johannes Han, sot (e enjte) vjen në Shkup për t'u takuar me kreun shtetëror dhe me liderë të partive politike. Han do të takohet me presidentin Stevo Pendarovski, me kryeministrin Zoran Zaev dhe me liderin e VMRO-DPMNE-së në opozitë, Hristian Mickoski. Sipas agjendës

zyrtare, do të bisedohet për reformat lidhur me eurointegrimin e vendit dhe pritet që në vjeshtë të përcaktohet datë për fillimin e negociatave për anëtarësim. Pritet të flitet edhe për Ligjin e ri për prokurori publike me të cilin duhet të rregullohet statusi i ardhshëm i PPS-së. Është paraparë që kryeministri

Zaev dhe komisar Han pas takimit të mbajnë konferencë të përbashkët me gazetarë në Klubin e Deputetëve.

Një ditë më vonë për vizitë në vend duhet të vijë edhe ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Filip Riker. Ai vjen në Shkup nga Athina ku pati takime me shefin e diplo-

macisë greke, Nikos Dendias, me përfaqësues të tjerë qeveritarë, si dhe me ish-kryeministrin Aleksis Cipras.

Në Shkup, sipas paralajmërimit të Departamentit Amerikan të Shtetit, Filip Riker do të takohet me presidentin Stevo Pendarovski, me kryeministrin Zoran Zaev, ministrin e Punëve të



Jashtme Nikolla Dimitrov dhe përfaqësues të tjerë qeveritarë.

Boris Johnsoni merr detyrën e kryeministrit të Britanisë

Boris Johnsoni vjen në këtë post pas dorëheqjes së kryeministres Theresa May, e cila nuk arriti t'i bashkonte forcat politike dhe vendin në mbështetje të propozimeve të saj për Brexitin



ka premtuar gjatë fushatës që ta shkëpusë Britaninë nga Bashkimi Evropian brenda 31 tetorit, me ose pa marrëveshje mes dy palëve lidhur me kushtet e largimit. Shumë anëtarë të parlamentit janë kundër

idesë së shkëputjes pa një marrëveshje, duke thënë se një tentativë e tillë do të sillte kaos. Boris Johnsoni ndeshet me rezistencë të fortë nga një segment i konsiderueshëm i shoqërisë britanike që mbetet

pro-BE-së dhe që e sheh me antipati personalitetin e tij të bujshëm. Ai ka siguruar mbështetjen e konservatorëve të bardhë, të pasur, por shpreson të bëjë për vete edhe britanikë të tjerë. Johnson ka premtuar se do të krijojë një "kabinet për Britaninë moderne" ku do të ketë një numër më të madh grash dhe pakicash etnike në drejtimin e institucioneve. Përveç anëtarëve të kabinetit që do të jenë përkrahës të fortë të Brexitit, ai premtonte të përfshijë edhe politikanë pro-Bashkimit Evropian. Politikani që njihet për stilin teatral, batutat në latinisht dhe shkulët e flokëve të verdhë të parregullt do të duhet ta tregojë veten se është një udhëheqës i ekuilibruar, një kryeministër pragmatik, i fortë dhe elastik për t'i siguruar aleancat e nevojshme në mënyrë që ta drejtojë me sukses vendin në këtë moment historik.

LONDËR, 24 KORRIK - Boris Johnsoni mori të mërkurën detyrën e kryeministrit dhe përgjegjësitë e udhëheqjes së vendit gjatë procesit të vështirë dhe ende të paqartë të shkëputjes nga Bashkimi Evropian. Ai vjen në këtë post pas dorëheqjes së kryeministres Theresa May, e cila nuk arriti t'i bashkonte forcat politike dhe vendin në mbështetje të propozimeve të saj për Brexitin.

May mbajti fjalimin e fundit para Parlamentit britanik si kryetare e qeverisë. Në fjalët e lamtumirës ajo vlerësoi pasuesin e saj që do ta marrë tani drejtimin e vendit. "Me kënaqësi i kaloj udhëheqjen kreut të Partisë Konservatore

dhe kryeministrit të ri të cilin e kam pasur anëtar të kabinetit. Ai është një konservator me bindje, i cili iu përmbajt manifestit konservator në 2017-n për të punuar për një të ardhme të ndritur për vendin", tha May.

Pas fjalimit lamtumirës dhe pas përhëndetjes me stafin e zyrës së saj në Downing Street, May u takua me Mbretëreshën Elizabetë II për t'i paraqitur dorëheqjen dhe për t'i kërkuar që ta ftojë udhëheqësin e ri të konservatorëve, Boris Johnson, ta formojë qeverinë e re.

Pas kërkesës zyrtare të mbretëreshës, Johnson mori detyrën e kryeministrit dhe me të, barrën e vështirë të menaxhimit të procesit të Brexitit. Ai

Tensione para Teatrit Kombëtar në Tiranë

TIRANË, 24 KORRIK - Çaste të forta tensioni u regjistruan që prej mëngjesit të mërkurës përpara godinës së Teatrit Kombëtar në Tiranë, ku pati përplasje mes forcave të policisë dhe një grupi artistësh dhe qytetarësh që kundërshtojnë projektin e qeverisë për ta prishur godinën ekzistuese dhe ndërtimin aty, në kuadër të një kompleksi të madh pallatesh shumëkatëshe dhe të një ndërtese të re moderne të teatrit.

Gjithçka nisi kur pranë godinës së teatrit u shfaqën forca të Policisë së Rendit për ta siguru-



ar hyrjen e disa punonjësve të administratës të ngarkuar me

procesin e inventarizimit të materialeve. Artistët dhe disa

qytetarë të cilët e kishin kaluar natën në oborrin e teatrit tentuan edhe ata të hynin brenda "për të parë se çfarë po bënin aty punonjësit e administratës". Përplasjet vijuan për një kohë të gjatë, ndërsa numri i artistëve dhe qytetarëve protestues, edhe i forcave të Rendit, të cilëve iu bashkua edhe policia bashkiake, rritej. Situata pati çaste të forta acarimi, kur policisë iu desh t'i largonte me forcë artistët që kërkonin të hynin në godinë. Aktori dhe regjisori i njohur Edmond Budina tha se forcat e policisë e kishin tërhequr zvar-

rë. Protestës para teatrit iu bashkuan edhe përfaqësues të opozitës dhe më pas dhe kryetari demokrat Lulzim Basha. "Betejën po e bëjnë artistët dhe Aleanca për Teatrin. Ne jemi në mbështetje të tyre dhe do të jemi në mbështetje me të gjitha format dhe mjetet. Çdo përpjekje për ta hapur gropën e teatrit do të kthehet në gropën e Ramës", deklaroi Basha, sipas të cilit, projekti që synon prishjen e godinës aktuale dhe ndërtimin e një teatri të ri është një projekt grabitës.

Gjykata e Tiranës konfirmon mandatin e dytë të Erion Veliajt

TIRANË, 24 KORRIK - Gjykata e Tiranës ka miratuar mandatin e Erion Veliajt si kryetar i Bashkisë së Tiranës edhe për një mandat të

dytë. Në mbledhjen e së mërkurës, gjykata ka konfirmuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pas betimit në

mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak, Veliajt nis edhe zyrtarisht rrugëtimin si kryebashkiak për katër vjetet e ardhshëm. Pritet

që brenda kësaj jave gjykata t'i hapë rrugë konstituimit edhe të Këshillit Bashkiak që pritet ta nisë punën normalisht.



Ramush Haradinaj dhe Jakup Krasniqi janë paraqitur të mërkurën para Gjykatës Speciale e cila vepron në Hagë

Haradinaj dhe Krasniqi intervistohen nga Specialja, mbrohen në heshtje

Ramush Haradinaj dhe Jakup Krasniqi janë mbrojtur në heshtje të mërkurën gjatë intervistimit nga Prokuroria Speciale e Dhomave të Posaçme në Hagë. Ish-komandanti i UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit dhe ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së kanë deklaruar për media se me këtë veprim të tyre kanë kryer obligimet e veta ligjore



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 KORRIK - Ish-komandanti i UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj, dhe ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së, Jakup Krasniqi, kanë përfunduar të mërkurën intervistimin nga Prokuroria Speciale e Dhomave të Posaçme. Pas intervistimit, Ramush Haradinaj ka thënë se është mbrojtur në heshtje. "Sot jam paraqitur si i dyshuar. Kam kryer obligimin ligjor në bazë të një ftese të Prokurorisë Speciale të Dhomave të Posaçme. Kam pranuar këshillën ligjore që të mos

përgjigjem fare në pyetje", ka thënë Haradinaj për gazetarët në Hagë. Ai ka bërë me dije se nuk pret ngritjen e ndonjë aktakuze ndaj tij.

Haradinaj ka përsëritur të mërkurën se në Hagë ka dashur të intervistohet si qytetar i Kosovës dhe jo si udhëheqës shteti. "Imagjinojeni sikur lajmet të shkruanin sot se kryetari i Qeverisë së Kosovës po merret në pyetje. Unë kam ardhur si Ramush Haradinaj. E kemi ruajtur shtetin tonë të ri dhe kemi krijuar një precedent që i obligon të gjitha palët e tjera të na respektojnë, qofshin në rajon apo qofshin në bashkësinë ndërkombëtare", është shprehur Haradinaj. Ai

nuk ka dashur të flasë nëse edhe personalitetet e tjera duhet të veprojnë në këtë mënyrë. "Kam dhënë një shembull të respektimit të ligjit. Unë nuk po i jap askujt leksione, e kam bërë detyrën

time", ka theksuar Haradinaj. Kryeministri në detyrë ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi, duke shtuar se është pro arritjes se një marrëveshje në mes të dy shteteve. "Unë do ta respektoj çdo obligim ligjor. Për ne është me rëndësi ta tregojmë një shembull të respektimit të ligjit. Edhe agjendës time politike do t'i qëndroj besnik. Jemi për dialog pa kushte, pra jemi për një marrëveshje për njohje me Serbinë. Tregu për njohje nënkupton jo formula të tjera që janë të papërbalueshme për Kosovën", është shprehur Haradinaj.

Të mërkurën në Hagë është intervistuar edhe ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe ish-zëdhënësi i kësaj ushtrie, Jakup Krasniqi. Ai nuk dhënë detaje për medie, duke thënë vetëm se ka kryer një obligim ligjor. "Kemi kryer obligim ligjor konform ligjeve në fuqi. Faleminderit që keni ardhur dhe gjithë të mirat për juve!", është shprehur Krasniqi. Prokuroria Speciale nga janari i këtij viti ka intervistuar dhjetëra ish-pjesëtarë të UÇK-

së, duke përfshirë komandantë të zonave dhe eprorë të tjerë të lartë të UÇK-së. Ftesa për intervistim këto ditë ka marrë edhe ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Bislim Zyrapi, ish-anëtari i këtij shtabi, Sokol Bashota, ish-shefi i një zone operative, Shukri Buja.

Pas intervistimit të personave të dyshuar për kryerjen e veprës penale të krimeve të luftës, Zyra e Prokurorit Special me seli në Hagë, në rast se i vërteton dyshimet si të bazuara, atëherë mund t'i ngrehë akuzat ndaj të dyshuarve. Kështu ka thënë Ismet Salihu, profesor i të Drejtës Penale Ndërkombëtare. Sipas tij, duke u bazuar në rrjedhën e punës së Dhomave të Specializuara, që njihet si Gjykata Speciale për krimet e luftës në Kosovë, sidomos në dy muajt e fundit, procedura e gjykimit të personave të dyshuar do të fillojë së shpejti. Ai shpreh mendimin se nuk do të ketë ndërhyrje politike ndaj kësaj gjykate dhe se askush që është i pafajshëm nuk do të dënohet nga kjo gjykatë.



Kryesuesi Hyseni po qëndron për vizitë studimore në Austri

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, është duke qëndruar në një vizitë studimore në Vjenë të Austrisë, ku janë duke u trajtuar temat e parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Gjatë kësaj vizite studimore është duke u biseduar për parandalimin dhe ndjekjen penale të

larjes së parave dhe financimin e terrorizmit, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar lidhur me luftimin e dukurive kundërligjore të lartcekura. Po ashtu, do të trajtohen edhe tema të tjera që lidhen me hetimin dhe përvojat e Austrisë në luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë vizitë studimore po

marrin pjesë edhe prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorë të prokurorisë të tjera, gjyqtarë, zyrtarë policorë, përfaqësues të ATK-së dhe inteligjencës financiare. Kjo vizitë studimore është organizuar nga Ministria Federale e Financave të Austrisë dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC).





Përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike janë shprehur të gatshëm për zgjedhje të parakohshme

Partitë presin presidentin për t'i nisur konsultat për datën e zgjedhjeve

Subjektet politike të pozitës dhe të opozitës janë në pritje të lëvizjes së presidentit Hashim Thaçi për t'i filluar konsultat rreth caktimit të datës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, përfaqësuesit e partive politike janë shprehur të gatshëm që t'u drejtohen kutive të votimit. Ata i kanë bërë thirrje presidentit të vendit, Hashim Thaçit, që të mos bëjë vonesa të panevojshme për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. Ndërkaq presidenti Thaçi ende nuk ka bërë asnjë lëvizje në këtë drejtim

hjet e parakohshme janë të pashmangshme. Partia Demokratike e Kosovës është e gatshme për zgjedhje kurdo që ato caktohen. Ajo që mund të diskutohet tash është vetëm koha kur ato duhet të mbahen. Për këtë besoj se do të kemi konsulta edhe me partnerët e koalicionit të deritashëm dhe me partitë e tjera politike, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi", ka thënë Veseli. Edhe kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, prej të premtës kur ka dhënë dorëheqje ka përsëritur se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja. Pasi ka përfunduar intervistimin në Gjykatën Speciale, të mërkurën ai ka thënë se po kthehet i gatshëm për zgjedhje

të reja. "Jam i gatshëm për të gjitha, qoftë nëse na fton kryekuvendari për shpërbërjen e Kuvendit, qoftë presidenti për ta caktuar datën e zgjedhjeve. Nuk janë zhvillime të thjeshta. Jam detyruar që të jap dorëheqje. Tani duhet të shkohet në zgjedhje të reja. Për fat të mirë, ka stabilitet në Kosovë. Besoj se Kosova është e qëndrueshme. Nëse populli ma jep besimin, e vazhdoj punën, nëse jo, i uroj suksese kushdo që e merr besimin", është shprehur Haradinaj. Pas veprimit të kryeministrit edhe Nisma Socialdemokrate ka thirrur mbledhje të kryesisë së partisë duke treguar se është e gatshme për zgjedhje të reja. "Me dorëheqjen e Haradinajt

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 KORRIK - Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj të gjitha partitë politike kanë shprehur gatishmërinë e tyre për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Madje ato janë shprehur edhe

kundër formimit të një qeveri teknike, duke e ftuar presidentin e vendit, Hashim Thaçi, që t'i fillojë sa më parë konsultimet me partitë për caktimin e datës së zgjedhjeve. Mirëpo deri më tani shefi i shtetit nuk është deklaruar lidhur me këtë çështje. Kryetari i Partisë Demokratike

të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se pas dorëheqjes së kryeministrit zgjedhjet janë të pashmangshme. "Vendimi i ish-kryeministrit për dorëheqje është vendim personal dhe, si të tillë, e kemi pranuar, pavarësisht që për këtë nuk kemi pasur asnjë njoftim ose konsultë paraprake. Tashmë zgjed-

mbeten zgjedhjet e reja parlamentare. Lideri i këtij subjekti politik, Isa Mustafa, ka thënë se qeveria teknike në këtë kohë është fyerje për LDK-në. "Nuk pranojmë asnjë zgjedhje tjetër përveç zgjedhjeve të parakohshme. S'do të ketë qeveri teknike, por vetëm zgjedhje. Jemi në një situatë shumë të keqe si vend", ka thënë Mustafa pas mbledhje së kryesisë së LDK-së.

Kurse sekretari i përgjithshëm i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka deklaruar se data e zgjedhjeve duhet të caktohet bashkërisht. "Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja, por rrugën për të ecur përpara duhet ta vendosim bashkë, në një diskutim gjithëshoqëror", ka thënë Molliqaj.

PRESIDENTI ENDE NUK KA FOLUR PËR DATËN E ZGJEDHJEVE

Pavarësisht prej deklarimit të subjekteve politike për zgjedhje, deri të mërkurën presidenti Hashim Thaçi nuk ka bërë asnjë lëvizje për t'i konsultuar partitë politike dhe koalicionin fitues nëse do të propozojnë mandatar tjetër pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. E vetmja deklaratë e presidentit për këtë çështje ka qenë ajo e javës së kaluar, ku ka nënvizuar se do të veprojë bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore. "Unë e respektoj vendimin e tij (dorëheqjen e Ramush Haradinajt) dhe si president i Republikës së Kosovës ju siguroj se do të veprojë bazuar në kompetencat e mia kushtetuese dhe ligjore për të cilat qytetarët e Kosovës do të njoftohen me kohë", ka shkruar presidenti Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Kushtetuta e Kosovës saktëson veprimet që duhet t'i ndërmarrë shefi i shtetit pas dorëheqjes së kryeministrit të vendit. "Nëse kryeministri jep dorëheqje ose për arsye të tjera posti i tij/saj mbetet i lirë, qeveria bie dhe presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri për ta formuar qeverinë", thotë neni 95.5 i Kushtetutës.

Vazhdimi i dialogut, i ndërlidhur me formimin e qeverisë së re

Prishtinë, 24 korrik - Vazhdimi i dialogut midis Kosovës dhe Serbisë është gati se i pamundur pa formimin e Qeverisë së re të Kosovës, thonë njohësit e zhvillimeve politike në Prishtinë. Dorëheqja e Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës, sipas tyre, pa dyshim se do të ketë ndikim dhe efekte edhe në procesin e dialogut me Serbinë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian në vazhdimësi i kanë inkurajuar Prishtinën dhe Beogradin që të rikthehen në tavolinën e bisedimeve me synimin që marrëveshja finale për normalizimin e raporteve ndërmjet dy vendeve të nënshkruhet gjatë këtij viti.

Thirrjet e tyre ishin shpeshuar sidomos nga fundi i nëntorit të vitit 2018, kur Prishtina zyrtare vendosi taksën 100 për qind për të gjitha importet nga Serbia. Ky vendim i Prishtinës zyrtare u cilësua i papranueshëm nga Beogradi, i cili tashmë e ka vënë kusht shfuqizimin e taksës për kthimin në dialog.

Aktualisht Kosova ka një qeveri dhe kryeministër në dorëheqje. Kurse presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ende nuk ka ndërmarrë një veprim në bazë të të cilit do të sqarohet nëse vendi përfundimisht do të shkojë në zgjedhje të reja apo do të ketë tentativa për formimin e një qeverie të re. Derisa në Kosovë ka një gjendje të tillë politike, analistët nuk

parashikojnë mundësi që dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit të vazhdojë.

Jeta Krasniqi nga Instituti Demokrati i Kosovës ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se deri në formimin e institucioneve të reja procesi i dialogut do të ngadalësohet dhe të vazhdojë vetëm pasi institucionet kushtetuese të jenë funksionale. "Tani presidenti përfaqëson Kosovën brenda dhe jashtë vendit, por kur vjen puna te marrja e vendimeve, qoftë në politikën e jashtme, e kemi parë që është një përgjegjësi e cila i takon Qeverisë së Kosovës e cila duhet të bëhet në konsultim me presidentin dhe nën mbikëqyrjen e Kuvendit. Pra, duhet t'i kemi të tria këto hallka institucionale në funksionin e tyre të plotë kushtetues, në mënyrë që një proces i mirëfilltë i dialogut të mund të vazhdojë dhe të flitet në detaje për një marrëveshje eventuale midis dy palëve. Derisa nuk i kemi këto, nuk do të ishte, ta them kështu, në përputhje me obligimet që institucionet kanë", ka thënë Krasniqi. Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se nuk ka qëndrim kundër dialogut në çfarëdo etape. Ai deklaroi se Kosova edhe kështu i kryen funksionet e veta mirëpo, sipas tij, dialogu duhet të jetë pa kushte dhe jo dialog për ndarje.

Përparim Kryeziu nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike thotë se edhe rrjedha e takimeve

në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë deri tash ka qenë e paqartë dhe se, sipas tij, e vetmja shpresë për vazhdimin e dialogut ishte njoftimi se në muajin shtator në Paris do të mbahej një takim i ri. Kryeziu thotë se edhe në situatën e re të krijuar në Kosovë ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit, dialogu politik me Serbinë duhet të udhëhiqet nga Qeveria e Kosovës. "Kjo paqartësi mund të ofrojë ndoshta një hapësirë më të madhe manovruese që presidenti të arrijë një marrëveshje. Mirëpo, unë konsideroj se vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka qartësuar atë duke ia pamundësuar atij që të arrijë një marrëveshje dhe të negociojë një marrëveshje me palën serbe", ka thënë Kryeziu. Ai ka rikujtuar se çfarëdo marrëveshje që mund të nënshkruhet do të jetë e pamundur të zbatohet pa miratimin e saj në Kuvendin e Kosovës.

Përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, por edhe ata jashtë saj, kanë kërkuar që Kosova dhe Serbia sa më parë ta vazhdojnë dialogun për arritjen e një marrëveshjeje finale.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett u ka transmetuar një mesazh Prishtinës dhe Beogradit, që të kthehen në tavolinën e bisedimeve. "Është koha që Kosova dhe Serbia ta gjejnë rrugën e tyre në tryezën e negociatave", ka shkruar ambasadori Kosnett në llogarinë e vet në "Twitter".

vendi automatikisht shkon në zgjedhje. Të gjitha procedurat duhet të respektohen, por gjendja faktike është kjo, vendi do të shkojë në zgjedhje", ka thënë lideri i këtij subjekti politik, Fatmir Limaj.

Gatishmërinë për zgjedhje të parakohshme e ka konfirmuar edhe subjekti tjetër i këtij koalicioni qeverisës, AKR-ja.

Opozita paralajmëron seancë të jashtëzakonshme për shpërbërje të Kuvendit

Subjektet opozitare i kanë bërë thirrje presidentit të vendit, Hashim Thaçi, që sa më shpejt t'i fillojë konsultimet për caktimin e datës së zgjedhjeve, në të kundërtën, ato kanë paralajmëruar se do të thërrasin një seancë të jashtëzakonshme për ta shpërndarë Kuvendin.

Shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka deklaruar se nëse nuk caktohet data e zgjedhjeve, së bashku me LDK-në do ta thërrasin një seancë të tillë. "Nëse presidenti e vazhdon skenarin e PDK-së për mosmbajtjen e zgjedhjeve, atëherë javën e ardhshme e mbledhim Kuvendin dhe e shpërbëjmë Kuvendin", ka deklaruar Konjufca.

Edhe LDK-ja pas dorëheqjes së kryeministrit ka dalë me qëndrimin se e vetmja rrugë tani



Komuna e Deçanit në shërbim të bashkatdhetarëve

DEÇAN, 24 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se tashmë janë krijuar kushte më të mira për punë në administratën komunale dhe, sipas tij, deri më tani nuk është parë e nevojshme për zgjatjen e orarit të punës për shkak të sezonit veror. Pavarësisht prej kësaj, Ramosaj ka thënë se nëse do të ketë kërkesa edhe gjatë fundjavës si administratë komunale janë të gatshëm të jenë pranë qytetarëve, e sidomos pranë bashkatdhetarëve të cilët janë për pushime në Deçan.

Edhe drejtori i Administratës Komunale, Jashar Dobraj, ka bërë me dije se ky sezon veror e ka gjetur këtë administratë me të kompletuar se kurrë më parë. Ai ka thënë se pritet janë të shkurtra në këtë administratë ku, sipas tij, qytetarët brenda tre deri në pesë minuta mund t'i përfundojnë procedurat për marrjen e dokumenteve. Ai ka thënë se pajisja me certifikata të të gjitha llojeve nga Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me komunën këtë vit nuk ka munguar. Dobraj ka treguar se nga muaji

janar e deri më tani në Administratën Komunale të Deçanit janë lëshuar 30 593 certifikata të llojeve të ndryshme. E njëjta gjendje është edhe në dy qendra të gjendjes civile në Strellc dhe në Polana. Në Administratën Komunale në Deçan dhe në dy zyrat e gjendjes civile në fshatra Strellc dhe Polana mund të pajiseni me certifikatë të lindjes, ekstrakt të lindjes, certifikatë martesore, certifikatë të vdekjes, status martesor, deklaratë familjare, certifikatë të vendbanimit, vërtetim të arkivit dhe certifikatë të shtetësisë.



Bahtiri dhe Meha flasin për rregullimin e sistemit të ujitjes në tokat bujqësore me komasacion

MITROVICË, 24 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Egzon Jashari, kanë pritur në takim pune ish-kryeshefin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Murat Meha, si dhe ekspertin holandez nga fusha e gjeodezisë, Rutger Kuiper, i cili është me përvojë ndërkombëtare në lëmin e trajtimit të tokave dhe ujërave. Në këtë takim, Meha dhe Kuiperi kanë prezantuar idetë e tyre për hartimin dhe implementimin e masterplanit për rregullimin e sistemit të ujitjes në tokat bujqësore me komasacion.

Murat Meha ka thënë se ky masterplan do të hartohet në koordinim me Ministrinë e Bujqësisë, që është kompetente për trajtimin e zonave me



komasacion dhe implementimi i tij do të financohet nga Banka Botërore. Ndërsa kryetari i

Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka shprehur gatishmërinë dhe përkushtimin e tij që kjo çështje

të trajtohet duke marrë parasysh nevojën e rregullimit të këtyre zonave.

Drejtori Egzon Jashari ka prezantuar gjendjen e zonave me komasacion në Komunën e Mitrovicës Jugore, duke bërë me dije se ekzistojnë katër zona me komasacion të cilat gjenden në zonat kadastrale: Kçiq i Madh, Frashër, Koshtovë dhe Vinarci i Poshtëm dhe si tërësi gjenerojnë një sipërfaqe të përgjithshme rreth 725 hektarë. "Rëndësia e rregullimit të kësaj çështje është shumë e madhe pasi që jo vetëm që ndihmon pronarët t'i definojnë pronat e tyre në aspektin formal-juridik, por gjithashtu i mundëson edhe Zyres Kadastrale në Mitrovicë t'i mbulojë me të dhëna të plota kadastrale zonat në fjalë duke bërë njëkohësisht edhe zhbllokimin e tyre, me ç'rast do të harmonizohet gjendja faktike në terren me dokumentacionin kadastral", ka thënë Jashari.

Gurbardhi e Bubli në Malishevë bëhen me ndriçim publik



MALISHEVË, 24 KORRIK (ER) - Në kuadër të realizimit të njërit prej projekteve më të mëdha në Komunën e Malishevës, "ndriçimi publik në fshatra", ka përfunduar ndriçimi në fshatrat Gurbardh dhe Bubël. Kjo komunë ka njoftuar se ky projekt po shkon drejt përfundimit, ku është duke u rregulluar ndriçimi

në 18 vendbanime. Këtë vit gjysma e vendbanimeve do të bëhen me ndriçim dhe, varësisht prej mundësive buxhetore, deri në vitin 2020 shumica dërrmuese e fshatrave pritet të kenë ndriçim publik. Rregullimin e ndriçimit në Gurbardh e ka parë nga afër edhe kryetari i Komunës së

Malishevës, Ragip Begaj, i cili është ndarë i kënaqur me realizimin e projektit, sipas dinamikës së paraparë. Ndërsa në Bubël rregullimin e ndriçimit e ka inspektuar nënkryetari i kësaj komune, Hajdin Berisha. Gjatë inspektimit të punimeve Begaj e Berisha janë takuar edhe me banorët e këtyre dy fshatrave.

Ndahen 99 lopë për fermerët e Prizrenit

PRIZREN, 24 KORRIK (ER) - Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka bërë ndarjen e lopëve qumështore për blegtorët përfitues të Komunës së Prizrenit nga projekti "Furnizimi i blegtorëve me lopë qumështore". Me

rastin e dhënies së lopëve qumështore përfituesve, të pranishëm ishin edhe kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, nënkryetari Eshref Memaj dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Egzon

Elshani. Për këtë projekt kanë aplikuar gjithsej 193 aplikues, ndërsa përfitues janë përzgjedhur 99 sosh sipas vlerësimit të komisionit, i cili është bazuar në kriteret e përcaktuar nga thirrja e hapur publike. Blegtorët

përfitues kanë participuar në këtë projekt me 35 për qind, ndërsa pjesa tjetër i ka takuar Komunës së Prizrenit. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i përfituesve nga ky projekt sivjet është rritur për rreth 20 për qind.



Në Maqedoninë e Veriut arrestohet ish-pjesëtari i UÇK-së

PRISHTINË, 24 KORRIK - Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka dënuar arrestimin shtetasit të Kosovës, Tomor Morina, ish-pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nga ana e policisë së Maqedonisë së Veriut. Morina është arrestuar

në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Interpoli me kërkesë të Serbisë. "Ky është edhe një tjetër shembull i abuzimit politik që kryen Serbia përmes këtyre kërkesave për arrest", ka thënë shefi i kabinetit të ministrit të Jashtëm

të Kosovës, Jetlir Zyberaj. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës do t'i drejtohen menjëherë Bashkimit Evropian me kërkesë që t'i parandalojë rastet e tilla. "Ne jemi në kontakt të ngushtë me autoritetet në Shkup dhe besojmë se rasti do

të zgjidhet sa më parë në bazë të frymës së bashkëpunimit që kemi me Maqedoninë e Veriut", ka shtuar Zyberaj. E pyetur nga "Radio Evropa e Lirë", Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut nuk ka dhënë detaje lidhur me



statusin e tij aktual, por ka njoftuar se ndaj shtetasit kosovar do të respektohen të gjitha procedurat ligjore.

Policia arreston 18 persona për trafikim të armëve dhe municioneve

Policia e Kosovës gjatë operacionit "Shënjestra" në nivel vendi ka kontrolluar 27 lokacione të ndryshme, ka arrestuar tetëmbëdhjetë persona të cilët me urdhër të prokurorit janë dërguar në mbajtje për 48 orë si dhe ka sekuestruar si prova materiale armë zjarri, fishekë, vetura dhe para



aksioni policor që ka rezultuar me 18 persona të arrestuar. Atyre u është caktuar masa e ndalimit në kohëzgjatje prej 48 orësh për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se po ata kanë kryer veprat penale "import, eksport, furnizim, transport, prodhim, këmbim, ndërmjetësim ose shitje të paautorizuar të armëve apo materieve plasëse".

Në të njëjtin njoftim thuhet se është sekuestruar edhe sasi e konsiderueshme e armëve dhe municioneve: 37 revole, tetë

armë gjuetie, tri armë AK-47, dy armë gjysmautomatike, shtatë armë të gjata, një pushkë ajrore, 18 karikatorë dhe pjesë të ndryshme të armëve, si dhe 25

telefona celularë. Përveç këtyre, gjatë këtij aksioni është thënë të jenë sekuestruar edhe një sasi e madhe e fishekëve, rreth 9 000 copë të kalibrave të ndryshëm, të holla në vlerë prej rreth 10 000 eurosh dhe dy vetura të cilat ky grup është thënë t'i ketë përdorur për kryerjen e veprës penale.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 KORRIK - Policia e Kosovës ka arrestuar 18 persona dhe ka sekuestruar sasi të konsiderueshme të armëve dhe lëndëve shpërthyes. Prokuroria Themelore në Ferizaj, përkatësisht Departamenti për Krime të Rënda, përmes një njoftimi ka njoftuar se, pas një hetimi dis-amujorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetimeve Kundër Krimin të Organizuar në Prishtinë, është ndërmarrë

aksioni policor që ka rezultuar me 18 persona të arrestuar.

Atyre u është caktuar masa e ndalimit në kohëzgjatje prej 48 orësh për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se po ata kanë kryer veprat penale "import, eksport, furnizim, transport, prodhim, këmbim, ndërmjetësim ose shitje të paautorizuar të armëve apo materieve plasëse".

Në të njëjtin njoftim thuhet se është sekuestruar edhe sasi e konsiderueshme e armëve dhe municioneve: 37 revole, tetë

Ministri Gashi nënshkruan memorandume bashkëpunimi me Komunën e Shtimes



PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të mërkurën në kabinetin e vet kryetarin e Komunës së Shtimes, Naim Ismajli. Në këtë takim në mes të ministrisë dhe komunës u nënshkruan dy memorandume bashkëpunimi. Njëri memorandum ka për qëllim ndërtimin e arkivit të qytetit në Shtime, tjetri përfundimin e punimeve në stadiumin e qytetit në Shtime. Këto projekte do të zbatohen gjatë vitit 2019.

Projekti i ndërtimit të arkivit të qytetit në Shtime mbështetet financiarisht nga ministria në vlerën 227 mijë euro, ndërkaq projekti për përfundimin e punimeve në stadiumin e qytetit në Shtime mbështetet me mjete financiare në vlerë prej 247 mijë eurosh. Pas nënshkrimit të këtyre memorandumeve, ministri Gashi u shpreh se këto investime bëhen me qëllim të mbështetjes financiare për projektet që kanë për qëllim krijimin dhe avancimin e

infrastrukturës sportive si dhe ndërtimin e objekteve për ruajtjen e dokumentacionit si ruajtje e kujtesës. Ai ka thënë se të dyja këto projekte janë mjaft të rëndësishme për Komunën e Shtimes.

Ndërsa kryetari Ismajli pasi falënderoi ministrin për pritjen u shpreh falënderues edhe për mbështetjen e tij financiare për hartimin dhe zbatimin e këtyre projekteve shumë të rëndësishme për Komunën e Shtimes.

Matoshi dhe Begaj nënshkruajnë memorandume për projekte mjedisore në Malishevë

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, dhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, të mërkurën kanë nënshkruar memorandume të bashkëpunimit për vazhdimin e financimit të dy projekteve: "Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Lladrovç - Carrallukë" në vlerë prej 200 mijë eurosh dhe "Rregullimi i shtratit të lumit Mirusha" në vlerë prej 100 mijë eurosh për vitin buxhetor 2019. Ministri Matoshi ka thënë se këto

dy projekte kanë për qëllim përkrahjen e komunës për përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe ngritjen e nivelit të mirëqenies së qytetarëve. "Këto dy projekte MMPH-ja i ka financuar që nga fillimi i tyre, kurse me mjetet buxhetore të ndara për këtë vit do të arrihen të përfundohen projektet me sukses. Uroj që këto dy projekte të realizohen me kohë dhe të kenë një menaxhim efikas nga Komuna e Malishevës", ka thënë ministri Matoshi.

I pari i MMPH-së, Matoshi, ka

treguar se Komuna e Malishevës po mbështetet edhe me projektin "Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza që lidh fshatrat Plloqicë - Bubël" në vlerë prej 350 mijë eurosh për këtë vit. Ministri Matoshi dhe kryetari Begaj kanë biseduar edhe për zbatimin e ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, me ç'rast Matoshi ka kërkuar nga kryetari Begaj fillimin e zbatimit të këtij ligji.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka falënderuar ministrin Matoshi



për bashkëpunim duke vlerësuar se projektet e financuara nga MMPH-ja do të ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit në komunën që ai drejton. "Këto dy projekte janë në përfundim e sipër dhe besoj se këtë vit do të përfundojnë në tërësi. Kjo do të

jetë një mundësi e mirë për ruajtjen e ambientit në Komunën e Malishevës dhe qytetarët. Përkushtimi juaj si ministër na bënë që të ndihemi mirë, ndërsa angazhimi juaj është në dobi të qytetarëve tanë", ka deklaruar Begaj.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit (26 korrik 2018)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti Selatin NOVOSELLA

Më i fortë se sa guri i këtij atdheu të lashtë! Burrë i madh i kombit. Tërë jetën u shkri si qiriri për t'i dhënë dritë lirisë, duke luftuar me terrin e robërisë.

Atdhetar i pashoq dhe i paepur; simbol i pathyeshmërisë dhe rezistencës përballë vuajtjeve të gjata në burgjet serbo-jugosllave. Frymëzues i madh i brezave lirisdashës dhe i brezave pas nesh. Vepra e tij është e përjetshme! Ky është Adem Demaçi, që e deshëm dhe e duam. Ky është Bacë Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Smail Latifi

Lavdi e përjetshme, jetës dhe gjithë veprës suaj Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
(emri dhe mbiemri të palexueshëm)

Respekt të përherëshëm për atë që do të mbetet në kujtesën tonë kolektive si njeriu që sakrifikoi rininë e tij që ne të jemi të lumtur sot. Fryma jote atdhetare ka qenë, është dhe do të mbetet frymëzimi ynë më i madh. Qoftë i përjetshëm emri yt. Sa të rrojë toka e qielli deri atëherë do të përmendet edhe Ademi!

Lamtumirë Bacë!

27 korrik 2018,
Andi Belegu

Me rastin e vdekjes së heroit kombëtar, Bacës ADEM, kombi humbi luftëtarin më të devotshëm për kauzën tonë kombëtare. Personaliteti i Bacës Adem lind një herë në 50 apo 100 vjet. Tërë jetën ia kushtoi luftës për lirinë dhe ribashkimin kombëtar. Kaloi nëpër furtuna e tortura të shovinistëve serbomëdhenj, por kurrë nuk u largua nga lufta për zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare. Nuk kemi fjalë, sepse fjalori ynë është i varfër për të shprehur veprën e tij. Ai vdiq, për të mos vdekur. I qoftë i lehtë dhe i Kosovës, të cilës ia kushtoi tërë jetën. Ngushëllime gjithë kombit.

27 korrik 2018,
Prof. dr. Musa Limani

O Baca Adem, po Ti nuk ke vdekur o bacë, ngase gjithnjë do të jesh në mendjet dhe zemrat tona. Frymëzim atdhedashurie për brezat e ardhshëm. Lapidar nder shekuj. Të qoftë i lehtë dhe i atdheut!

27 korrik 2018,
Sami Dermaku

Bacë, faleminderit që dhe gjithçka për këtë tokë e atdhe!

27 korrik 2018,
Jakup Halimi

Baca Adem, njeriu i thjeshtë dhe i madhërishtëm. Njeriu që bëri epokën kombëtare shqiptare!

27 korrik 2018,
Mehmedali Rexhepi, shkrimtar

Respekt nga shoqata e të Burgosurve Politik, dega në Prizren. I përjetshëm qoftë kujtimi yt, për jetë e mot!

27 korrik 2018,
Nuhi Dakaj

Adem Demaçi, flakadani i lirisë, për brezin e tashëm edhe për brezat që do të vijnë!

27 korrik 2018,
Rezart Avdiu

I nderuari dhe shumë i respektuari Baca Adem; ju faleminderit për të gjitha ato vepra patriotike dhe kombëtare shqiptare. Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës për të cilën e ke sakrifikuar tërë jetën.

27 korrik 2018,
Isa Morina, veteran i luftës së UÇK-së

Prej sot Kosova dhe Shqipëria është më e varfër për birin e saj, i cili u bë digë në mbrojtje të kombit të tij. U bë lis i rrahur nga furtunat, por gjithmonë i pamposhtur. Lamtumirë Baca Adem Demaçi - Hero dhe Nderi i Kombit! Jemi krenar që të patëm udhërrëfyes në rrugën e lirisë!

27 korrik 2018,
Berat Luzha

O Baca ynë i shtrenjtë! O ylli polar, o zemra e Shqipërisë! Kujtimi për ty o bacë do të rrojë sa të rrojë Shqipëria, sa të rrojnë shkëmbinjtë e saj. Lavdi jetës, veprës e sakrificës së Bacë Adem Demaçit!

27 korrik 2018,
Idriz Mehmeti


I lehtë të qoftë dhe i Kosovës martire! Një jetë të tërë sakrificë e vuajtje dhe krenari. Prehu në paqe, Baca Adem!

27 korrik 2018,
Ismail Kastrati

Lavdi e përjetshme o Bacë, për kontributin e dhënë për atdheun që shumë e deshe dhe sakrifikove për të! Ishe ideali ynë, frymëzim për të dashur atdheun dhe lirinë e kombit. Ishe gjaku i pastër arbëror, andaj sa të jetoj kombi, emri yt do të jetë i gjallë!

27 korrik 2018,

Delegacioni i KK - Malishevë



Faksimil i përshtypjes të Hashim Thaçit, President i Republikës së Kosovës

Bacë - pa ty dhe dietë tuaja - kombi nuk do të kishte kuptim!

27 korrik 2018,
Abdylkadër (mbiemri i palexueshëm)

Daja Adem Demaçi, nipi, djali i Ukës nga Gllamniku. Për jetën tënde kur flasim, do të thotë se ju ia përkushtuat një jetë të tërë kombit dhe ju qoftë i lehtë dhe qe e deshët aq shumë!

27 korrik 2018,
Imer Mustafa, Gllamnik

Baca Adem, Ti ishe Babai jonë i dytë, krenaria, atdheu, rezistenca dhe drita jonë. Ashtu edhe do të mbetesh gjithmonë!

27 korrik 2018,
Antigona Hasani

Baca Adem; jeni krenaria e kombit tonë! Gjithmonë në mendjet dhe zemrat tona! Respekt!

27 korrik 2018,
Hana Berisha

Bacë!
Lum Ju çfarë keni bërë për Kosovën dhe popullin tuaj kudo që është. Je i pavdekshëm për jetë! Lavdi!

27 korrik 2018,
Nakie Berisha

Bacë Adem
Ti më mësove si ta dua atdheun dhe si ta respektoj atë. Vepra jote do të jetë e pavdekshme. Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës!

27 korrik 2018,
Teuta Berisha

Baca Adem!
Na bën hallall se ke hjek me ne shqiptarët...! Na mësove si me dashtë vendin dhe me luftue për liri. Faleminderit Bacë!

27 korrik 2018,
Bedri Llapashtica

Familja Ethem (Lada); As vet nuk po di çka me shkruie, pak është me kanë me shkollë për Bacën Adem Demaçin! Veprat e Bacës falsin vet!

27 korrik 2018,
Muharrem dhe Hazbie Sylejmani

Vepra kolosale kombëtare e bacës Adem është skalitur në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

27 korrik 2018,
Naim Jerliu

Iu qoftë i lehtë dhe i Kosovës që aq shumë keni dhënë për të! Koha po e dëshmon çdo gjë!

27 korrik 2018,
Bedri Osmani

Bacë Adem Demaçi qëndroi vertikal gjatë gjithë jetës se vet. Ju ishit frymëzim për gjithë rininë, studentët, arsimtarët dhe gjithë popullin shqiptar. Unë isha vazhdues i veprës.

Lavdi jetës dhe veprës suaj!

27 korrik 2018,
Halit Elshani



Vëllai im, fqinji im, profesori im; të qoftë i lehtë dhe i Kosovës! Lavdi jetës dhe veprës suaj!

27 korrik 2018,
Abdyl Berbatovci

I përherëshëm qoftë kujtimi për Bacë Ademin, njeriun e personalitetin e madh prej atdhetari, deri te vetë-mohimi! Lavdi jetës dhe veprës se tij të pavdekshme!

27 korrik 2018,
Sabit dhe Sadie (mbiemri i palexueshëm)

Përjetësisht do të jesh simbol i rezistencës dhe qëndresës. Shembull i luftës këmbëngulëse për lirinë e pavarësinë e Kosovës. Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës, për të cilën u flajove.

27 korrik 2018,
Sedat Kuçi

Vetë jeta jote ishte luftë për lirinë e Kosovës, ju simbol i rezistencës, ju jeni vetë gurthemeli i shtetësisë se Kosovës. Lavdi jetës dhe veprës tënde! I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty!

27 korrik 2018,
Shefqet Musliu, Komandant i UÇPBM-së

Në emër të qytetarëve të Kamenicës përkulem para veprës së bacë Adem Demaçit.

27 korrik 2018,
Qendron Kastrati, kryetar i Kamenicës

Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës, Bacë. Të pata mik të madh, të falënderoj për të gjitha. Prehu në paqe!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Adem Demaçi ishte simbol i qëndresës dhe rezisten-cës për çlirimin e Kosovës por edhe të gjitha trojeve shqip-tare nga okupatori serbo-sllav. Ishte dhe do të mbetet udhërrëfyes se si duhet luftuar për të drejtat dhe lirinë edhe sot nëse është nevoja.

27 korrik 2018,
Mehmet Bardhi
Veli Havolli

Lavdi jetës dhe veprës së simbolit kombëtar të rezistencës shqiptare, Bacë Adem Demaçit!

27 korrik 2018,
Refki Suma, kryetar i Hanit të Elezit

/Vazhdon në numrin e ardhshëm/

Qarkullimi Kosovë - Shqipëri, me më shumë shirita

VERMICË, 24 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të mërkurën ka marrë pjesë në përrurimin e zgjerimit dhe rehabilitimit të hyrjes së pikës kufitare Kosovë - Shqipëri në

Vërmicë. Ministri Lekaj me këtë rast ka deklaruar se revitalizimi i pikës kufitare do të ndikojë në lëvizjen më të lirë të qytetarëve dhe mallrave nga të dyja anët e kufirit. Ai ka shtuar se edhe në

vazhdim do të punohet që ky kufi të mbetet simbolik. Mes të tjerash, Lekaj ka theksuar se pret që infrastruktura rrugore të zgjerohet edhe në hyrjen e kufirit nga ana e Shqipërisë.

Për dhjetë ditë Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, në kuadër të mirëmbajtjes rrugore, asfaltoi shiritat shtesë dhe ata janë, si dhe shtoi shenjëzimin bashkë me ndriçim.



Nga taksa 100 për qind Kosova ka përfituar 7 milionë euro

Në debatin me temën "Taksa 100 për qind, kush fitoi e kush humbi dhe çfarë?", zëvendësministri në detyrë i Financave, Fatmir Gashi, ka thënë se vendimi i Qeverisë së Kosovës për t'u vendosur taksë mallrave serbe kishte për qëllim ta ndalojë agresivitetin e Serbisë ndaj Kosovës. Ai ka thënë se nga taksa e vendosur Kosova ka përfituar 7 milionë euro nga të hyrat doganore. "Buxheti i Kosovës s'ka humbur asgjë, vetëm ka përfituar", ka thënë zëvendësministri Gashi



që të furnizohen me mallra cilësore nga Serbia. Përfitues janë tregtarët nga vendet e tjera që kanë furnizuar. Fitues, po ashtu, është Ramush Haradinaj, ndërsa humbës nga taksa është presidenti Hashim Thaçi, i cili nuk arriti ta realizojë idenë e tij për kufijtë. Andaj, taksa është një marrëzi, përfitues janë individë në skenën politike", u shpreh Radosavleviq. Sipas tij, katastrofa humanitare ka qenë e inskenuar

nga presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiq. Ndaj deklaratis së Nenad Radosavleviqit ka reaguar zëvendësministri Gashi, i cili ka thënë se nuk është marrëzi të marrësh masa ndaj një shteti që nuk e njeh Kosovën dhe produktet e saj. Kryetari i Shoqatës "Konsumatori", Selatin Kaçaniku, ka thënë se taksa 100 për qind për produktet e Serbisë nuk është marrë në

bashkëpunim me konsumatorët dhe, sipas tij, asnjëherë nuk është thënë nga Qeveria se kjo taksë është në dobi të tyre. "Ne e përkrahim masën ndaj Serbisë, edhe pse nuk u pyetëm. Ne kemi qenë gjithëherë që të respektohen kontratat për plotësimin e direktivave evropiane. Qytetari taksapagues është gjenerues i buxhetit dhe shteti ka obligime shtesë ndaj tyre", ka deklaruar Kaçaniku.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 KORRIK - Në debatin e organizuar me temë "Taksa 100 për qind, kush fitoi e kush humbi dhe çfarë?", kryetari i Asociacionit të Afaristëve Serbë në Kosovë, Sasha Sekuliq, ka thënë se me taksën e vendosur sektori i tregtisë ka pasur më së shumti probleme. Sipas tij, nga 1 000 artikuj sa kanë qenë në qarkullim, shumica prej tyre mungojnë.

Problem tjetër, sipas Sekuliqit, është edhe mungesa e produkteve bujqësore. "Kemi menduar se taksa shumë shpejt do të hiqet, ndërsa tash, me dorëheqjen e kryeministrit dhe me mbajtjen e zgjedhjeve të reja, taksa shtyhet", ka deklaruar Sekuliq. Zëvendësministri në detyrë i

Financave, Fatmir Gashi, ka thënë se vendimi i Qeverisë së Kosovës për t'u vendosur taksë mallrave serbe kishte për qëllim ta ndalojë agresivitetin e Serbisë ndaj Kosovës. "Kosova ka përfituar shtatë milionë euro nga të hyrat doganore. Buxheti i Kosovës s'ka humbur asgjë, vetëm ka përfituar. Zëvendësimi i produkteve serbe është bërë nga shtetet fqinjë dhe BE-ja. Qeveria ka pasur një mori arsyesh për mbajtjen në fuqi të taksës", ka thënë Gashi, duke shtuar se humbës nga taksa janë vetëm bizneset në Serbi.

Ndërsa Nenad Radosavleviq, iniciues i "Lidhjes për Serbi", ka thënë se taksa 100 për qind është një marrëzi dhe, siç ka thënë ai, me këtë vendim është e pakuptimtë të pritet njohja nga Serbia. "Humbës janë banorët e Kosovës

Telekomi u kërkon falje konsumatorëve për problemet e shfaqura në operatorin 'Vala'



PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Telekomi i Kosovës ka bërë me dije se të mërkurën janë shfaqur disa probleme në sistemin operativ të telefonisë mobile "Vala". Sipas njoftimit të kësaj kompanie, ekipet teknike janë duke bërë përpjekje maksimale që t'i eliminonjë të gjitha problemet e shfaqura sa më shpejt që të jetë e mundur. "Për shkak të disa problemeve teknike të shfaqura në

sistemin operativ të 'Vala'-s gjatë ditës së sotme janë evidentuar kohë pas kohe pengesa në komunikim dhe si pasojë komunikimi nuk ka qenë i mundur në disa shërbime në rrjetin mobil të 'Vala'-s në disa zona të caktuara. Ekipet teknike janë duke bërë përpjekje maksimale që t'i eliminonjë të gjitha problemet e shfaqura sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që ta rikthe-

jnë funksionimin normal të të gjitha shërbimeve si në gjendjen e mëparshme, për të siguruar komunikim të pandërprerë për të gjithë konsumatorët tanë. Edhe një herë Telekomi i Kosovës u kërkon falje dhe mirëkuptim të gjithë konsumatorëve të cilët mund të kenë vështirësi eventuale në komunikim!", është thënë në njoftimin e Telekomit të Kosovës.

Ministria e Diasporës hap Panairin Tradicional të Diasporës

Prishtinë, 24 korrik (ER) - Organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, është hapur të mërkurën Panairi Tradicional i Diasporës. Me panairin tradicional të artizanaleve, hapet edhe zyrtarisht

manifestimi zyrtar "Ditët e Diasporës". Zëvendësministri i Diasporës, Isni Kilaj, e ka hapur panairin duke përshëndetur të gjithë pjesëmarrësit në emër të zëvendëskryeministrit, ministrit të Diasporës, Dardan Gashi. Kilaj ka theksuar se Ministria e


Diasporës dhe Investimeve ka qëllim parësor mbështetjen dhe promovimin e diasporës, prandaj edhe ky panair është plotësisht në kuadër të kësaj mbështetjeje. "Ky panair i artizanaleve ka po këtë mesazh, po këtë qëllim, sepse ne jemi të interesuar të jemi afër diasporës. Ju ftojme të gjithëve të

merm pjesë në këtë panair, sidomos mërgimtarët që të kontribuojnë edhe në këtë aspekt", ka thënë Kilaj. Panairi me punime artizanale, veshje kombëtare dhe ushqime tradicionale mbetet i hapur në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë deri më 27 korrik 2019.



Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (9)

Veprimi i fushës antimagnetike të diellit



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Eksperimenti i mëparshëm kishte një lidhje se si reagojnë trupat qiellorë (Hëna) kur vendosen në hapësirën e ndonjë trupi tjetër qiellor (Tokë). Kurse tani do të shohim se si reagojnë trupat qiellorë që kanë një fushë magnetike dhe ndodhen në fushën magnetike të ndonjë trupi tjetër qiellor, përkatësisht si reagon toka që ka një fushë magnetike kur ndodhet brenda fushës magnetike të Diellit.

Vlen të theksohet se edhe te rasti i dytë, kur në vend të sferës së hekurit (Fe) në vrimën eksperimentale të diskut e vendosim një sferë të magnetizuar (N.S), shih figurën 38. Prapë kemi të njëjtat rezultate eksperimentale.

Kjo ndodhë për faktin se sfera e magnetizuar e cila ka fushën magnetike ((b)) ? pozicionohet në të njëjtin drejtim dhe kah të njëjtë me fushat magnetike ((B)) ? të magnetëve permanente (N.S). Edhe në këtë rast si në rastin e mëparshëm te sfera e hekurit (Fe) vijat e fushës antimagnetike ((-B)) që burojnë nga ana anësore e magnetëve permanente cilindrike (N.S) tentojnë që sferës magnetike t'ia ndërrojnë tërësisht drejtimin e poleve magnetike, me ç'rast kahja dhe drejtimi i fushës magnetike të sferës ((b)) ? të jetë e njëjtë me kahun e fushës antimagnetike ((-B)) ? e cila buron nga ana anësore e magnetit cilindrik (N1 S1)

Kahja e fushave magnetike ((B)) ? dhe fushave antimagnetike ((-B)) ? për shkak të kahut të kundërt, konsiderohen si forca shtytëse, prandaj në këtë rast dhe në këto rrethana, sfera e magnetizuar e kërkon atë gjendje të qetësisë në të cilën është në gjendje ta mbajë stabile fushën magnetike të sferës së magnetizuar ((b)) ? të orientuar vetëm në drejtim të fushës magnetike ((B)) ?, e cila konsiderohet si burim kryesor i magnetizimit të sferës së hekurit (Fe). Veprimi i njëkohshëm i këtyre dy forcave shtytëse (F) dhe ((-B)) ? në sferën e magnetizuar e cila gjendet në gjendje të lirë dhe të pafiksuar mbi magnetin (N1 S1) mbi të cilin janë vendosur pllakate hekurit (AB), do ta detyrojë sferën e magnetizuar të largohet në një distancë (d) në drejtim të periferisë, në një gjendje të qetësisë ku te sfera e magnetizuar kahja dhe drejtimi i fushës magnetike ((b)) ? do të jenë të orientuara në një drejtim të fushës magnetike ((B)) ?.

Konkludim

Nuk ka asnjë ndryshim në mes sferës së e hekurit (Fe) dhe sferës së magnetizuar të cilat vendosen në mjedise të rrethuara me fusha të njëjta magnetike, pavarësisht kahjes dhe drejtimit të atyre fushave magnetike ((B)) ?.

Që do të thotë se sikur sfera e hekurit (Fe) që vendoset në fushën magnetike ((B)) ? ajo magnetizohet, sikur sfera magnetike që është e magnetizuar, në të dy rastet vepron forca shtytëse mbi këto sfera atëherë dhe vetëm atëherë kur polet e magnetëve mbulohen me materiale ferromagnetike.

Ky eksperiment ka lidhshmëri me trupat qiellorë që kanë një fushë magnetike dhe ndodhen brenda fushës tjetër magnetike, ashtu sikur toka posedon një fushë magnetike dhe ndodhet në fushën magnetike të diellit.

Ngjashmëria ndërmjet Diellit, Tokës, Jupiterit, Saturnit, Uranit dhe Neptunit

Bazuar në analizat dhe eksperimentet e lartpërmendura mbi prezencën e fushës antimagnetike te toka ((-B)) ? e cila krijohet, atëherë dhe vetëm atëherë kur polet magnetike mbulohen me materiale ferromagnetike, hapet mundësia që këtë fushë antimagnetike ((-B)) ? ta hasim në cilindro trup qiellor te i cili vërehet fusha magnetike rreth të cilës rrotullohen trupa të tjerë qiellorë.

Po t'i bëhet një analizë e përgjithshme këtyre trupave qiellorë, nxjerrim pothuajse të gjitha elementet e përbashkëta: 1. Dielli, Toka, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni posedojnë fusha magnetike, 2. Fusha antimagnetike e ka të vetmin burim fushën magnetike, 3. Kushti i vetëm që një trup qiellor të rrotullohet rreth një trupi tjetër është prezenca e fushës antimagnetike, 4. Rreth diellit rrotullohen planetë kurse rreth planetëve rrotullohen satelitë natyralë. 5. Të gjithë këta trupa ndodhen në një hapësirë të vogël brenda galaksisë sonë, 6. Te të gjithë gjejmë elemente të njëjta me masa të ndryshme, dhe 7. E vetmja gjë që ndryshon janë dimensionet dhe mbështjellësit e jashtëm qofshin të gaztë të ngurtë apo të lëngët. Do të ishte e paimagjinueshme në aspektin shkencor që një trup qiellor si toka ta ketë një burim të fushës magnetike kurse një trup tjetër si dielli ta ketë një burim tjetër të fushës magnetike.

Ne mund të shkruajmë çfarë të dëshirojmë, por në realitet nuk kemi futur inxhinier në brendësi të diellit dhe të tokës të krijojnë fusha magnetike nga burime të ndryshme.

Nuk mund të ketë rufe që buron




Fig 38




Fig 39




Fig 40

nga retë dhe rufe që buron nga uji apo toka.

Fenomenet natyrore kanë të njëjtën origjinë, kështu që të gjithë trupat qiellorë të Universit kanë të njëjtën origjinë të formimit, janë formuar nga fenomenet e njëjta të cikloneve gjatë reaksionit ndërmjet atomeve (aX) dhe (aY).

Të njëjtën origjinë e kanë edhe të gjitha fushat magnetike që janë krijuar nga fenomenet e tornadove elektromagnetike ndërmjet atomeve (ax) (aZ) te të gjithë trupat qiellorë pavarësisht se si janë krijuar këto fusha.

Edhe fusha antimagnetike ka të njëjtën origjinë te të gjithë trupat qiellorë në mbarë Universin prandaj edhe struktura e brendshme e tyre prej nga burojnë këto fusha është tërësisht identike. (shih figurën 39).

Konkludim

Çdo trup qiellor i cili posedon një fushë magnetike, rreth të cilit trup rrotullohen trupa të tjerë qiellorë, posedon fushë antimagnetike si e vetmja forcë që mbron dhe e parandalon goditjen e atij trupi nga trupat e tjerë qiellorë. Kjo fushë antimagnetike buron nga anët anësore të dipoleve magnetike, atëherë dhe vetëm atëherë kur polet e atij magneti mbulohen me materiale ferromagnetike, kjo forcë quhet fushë antigravitacionale ((-G)) ?

Strukturat e brendshme të Diellit dhe Tokës janë identike

Edhe pse të gjithë shkencëtarët

dhe agjencitë shkencore e japin në një formë strukturën e brendshme të Diellit si një trup i përbërë rreth me 92 për qind Hidrogjen dhe 8 për qind helium, kjo nuk është e vërtetë.

E vërteta është vetëm një, se nuk ka asnjë ndryshim në strukturën e brendshme ndërmjet diellit dhe tokës (shih figurën 40) e vetmja gjë që i dallon është e sasia (masa) e materialeve ferromagnetike mbi polet magnetike, forca e Tornadove elektromagnetike e cila e krijon fushën elektrike dhe magnetike të diellit dhe Tokës, dhe forca e ciklonit që i detyron trupat tjerë të rrotullohen rreth tij.

Efektet e fushës antimagnetike në organizmin e njeriut

Fushat antimagnetike si të diellit dhe tokës ((-B)) ? por edhe të gjithë trupave të tjerë qiellorë qoftë brenda apo jashtë sistemit tonë diellor, ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e njeriut. Efektet e saj qoftë pozitive apo negative ndikojnë tek njeriu varësisht nga pozita e tokës në raport me diellin dhe Hënë në raport me tokën, duke përfshirë edhe pozitën e trupave të tjerë qiellorë në raport me tokën.

Si efekte pozitive, pa të cilat nuk do të mund të jetonte njeriu në tokë janë, mbrojtja nga goditja e trupave të tjerë qiellorë, fenomenet e baticës dhe zaticës, të cilat e mundësojnë qarkullimin e ujit në planetin tonë, dhe shpërndarja e fushës magnetike me ç'rast zvogëlohet

intensiteti i fushës magnetike në sipërfaqen e tokës.

Efektet pozitive të fushës antimagnetike të diellit janë shpërndarja e dritës dhe energjisë së nxehtësisë.

Krahas efekteve pozitive ka edhe efekte mjaft negative të fushave magnetike, sikur ajo që buron nga toka, dielli dhe çdo trupi qiellor që posedon fusha dhe antifusha magnetike që kalojnë nëpër tokë. Dihet që në organizmin e njeriut ka prezencë të hekurit (Fe) në gjak. Momentet magnetike të atomeve të hekurit (Fe) në gjak apo dipolet magnetike të hekurit (Fe) në gjak në jetën e përditshme orientohen në drejtim të fushës magnetike të tokës që konsiderohet si një forcë e parë.

Fusha antimagnetike e tokës që është një forcë antigravitacionale ((-G)) ? vepron me forcë shtytëse gjithmonë në drejtim të Hënës, prandaj intensiteti i saj maksimal arrihet në pozitën kur Hëna ndodhet më afër tokës.

Në këtë rast, fusha antimagnetike si një forcë e dytë tenton me forcë t'i orientojë momentet magnetike të hekurit (Fe) në gjak në kahje dhe drejtim të fushës antimagnetike.

Nga ana tjetër, kemi edhe fushën antimagnetike të diellit e cila është shumë efikase dhe ka një forcë jashtëzakonisht të madhe mbi planetin e tokës dhe konsiderohet si një forcë e tretë e cila tenton që momentet magnetike t'i orientojë në kahje dhe drejtim të njëjtë me këtë fushë antimagnetike të diellit, duke mos përfshirë edhe ndikimet e fushave dhe antifushave magnetike të trupave të tjerë qiellorë, që konsiderohen si forca e katërt.

Në këto rrethana, momentet magnetike të hekurit (Fe) në gjak bëjnë lëvizje kaotike dhe nuk mund ta mbajnë një gjendje stabile dhe të jenë të orientuara në drejtim të fushës magnetike të Tokës.

Kjo lëvizje kaotike e dipoleve magnetike bëhet edhe më agresive në kohën kur Hëna ndodhet më afër tokës dhe kur toka ndodhet më afër diellit.

Por, si do që të jetë, efektet vërehen më shumë duke filluar nga shtatori deri në mars kurse arrijnë kulmin me elemente negative rreth 4 janarit.

Të gjitha këto në organizmin e njeriut shkaktojnë shumë çrregullime nga më të lehtat deri te ato serioze si janë, dhe shkalla e seriozitetit varet sidomos nga prezenca e hekurit (Fe) në gjak. Efekte më shumë negative kanë ata njerëz që jetojnë afër largpërçuesve të rrymës elektrike, sepse fusha antimagnetike e diellit duke mos përfshirë edhe Jupiterit, Saturnin dhe trupa të tjerë qiellorë, që me fushat e tyre antimagnetike këto valë elektromagnetike që formohen rreth përçuesve t'i kthejnë në tokë. **Vijon.**

E rrallë

Shpallet hoteli më i mirë i plazhit për vitin 2019

Hotelet janë ato që i bëjnë pushimet çlodhëse ose jo, ndaj faqja turistike "TripAdvisor", një nga më të famshmet në botë, poston çdo vit hotelet më të preferuara nga udhëtarët. Në këtë listë hyjnë vende nga e gjithë bota, restorante dhe hotele të ndryshme. Për vitin 2019 hoteli më i mirë është shpallur "Tulemar", në Kosta Rika.



BARSOLETA E DITËS



Gjakovari ia rrëfen një ndodhi dashnores:
 - Zemër, jam lënduar shumë.
 - Pse shpirt?
 - Atë ditë që dola me ty më kanë humbur dy euro, edhe dy të tjera më humbën sot.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



FOTO E DITES



Barinjte shihen në rrugët e Parisit me një tufë delesh. /Reuters/

Ne ora 18:00
"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,
 Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



E jashtëzakonshme Kapen 5 milionë dollarë kallëpe floriri rrugës për në Zvicër

Rreth 5 milionë dollarë flori që mendohet se kanë lidhje me kartelet e Amerikës së Jugut janë kapur nga autoritetet e aeroportit të Londrës. Kallëpet ishin dërguar nëpërmjet një avioni privat që nga Venezuela, pastaj kishin shkuar në ishujt Kajman, prej aty kishin hyrë



në aeroportin Hithrou të Londrës, gati për të shkuar në Zvicër.

Ne ora 22:00
"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Ditë kaotike me plot ngjarje, por ju jeni gjithë kohës në humor. Janë ditë e fundit para pushimeve dhe çdo gjë ju duket e bukur.</p>	 <p>DEMI Do të ketë një kombinim të kënaqësisë dhe detyrës gjatë ditës, por që do t'ju bëjë më të përgjegjshëm t'i ndani me personat me të cilët komunikoni.</p>	 <p>BINJAKËT Edhe pse karriera ju shqetëson në këto çaste, duhet të dini se nuk mund ta zaptojë gjithë kohën tuaj.</p>	 <p>GAFORRJA Sot do të bashkëpunoni me persona të tjerë për realizimin e një projekti. Po eksperimentoni disa metoda që ju interesojnë.</p>	 <p>LUANI Keni lejuar disa persona që t'ju thonë se çfarë dhe si duhet ta bëni një gjë. Tani preferoni që t'i zgjidhni vetë problemet tuaja.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Po nervozoni personat pranë jush që do të preferoni të kaloni orë të këndshme në shoqërinë tuaj, jo t'ju jepnin shpjegime të kota.</p>
 <p>PESHORJA Mbase po i kushtoni më shumë rëndësi sesa që duhet një situatë të caktuar. Në këtë ditë ju nevojitet të merrni vendime të prera.</p>	 <p>AKREPI Po lini pas vetes shumë çështje të pazgjidhura dhe shumë dyshime si në anën profesionale, po ashtu edhe në atë personale.</p>	 <p>SHIGJETARI Planet tuaja për ditën e sotme do të modifikohen nga personat që janë pranë jush. Kjo është një gjë mjaft e mirë sepse do të kënaqeni më shumë.</p>	 <p>BRICJAPI Duke ndenjur dhe duke u menduar pa fund, mos kujtoni se do t'i zgjidhni problemet që ju shqetësojnë. Pak initiative për të lëvizur do t'ju bënte mirë.</p>	 <p>UJORI Dita e sotme do të shkojë shumë më keq sesa që e kishit menduar. Mjafton mos t'ju mposhtë pesimizmi.</p>	 <p>PESHQIT Nëse doni të vazhdoni të harxhoni kohë me gjëra të kota, është në dorën tuaj. Bëni mirë t'i kushtoni më shumë kohë familjes.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Azemi: Kosova ka shanse për kualifikim

Një prej basketbollistëve me përvojën më të madhe në Përfaqësuesen e Kosovës, Edmond Azemi, beson se "Dardanët" i kanë të gjitha shanset të kualifikohen. "Britania ka lojtarë shumë të mirë dhe po cilësohet favorite, megjithatë ne nuk do të dorëzohemi dhe besoj se në shtëpi mund të mposhtim çdo kundërshtar. Besoj se edhe kemi gjasa të mira për kualifikim", ka thënë Azemi

"Epoka e re"

PRISHTINË, 24 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll, pas zhvillimit të dy ndeshjeve miqësore ndaj Sllovakinë, po vazhdon përgatitjet për ndeshjet parakualifikuese që zhvillohen muajin e ardhshëm. Kundërshtarë të "Dardanëve" janë Luksemburgu dhe Britania e Madhe. Basketbollisti Edmond Azemi ka folur për rrjedhën e përgatitjeve, duke thënë se gjithçka po shkon në mënyrën më të mirë dhe se miqësoret e zhvilluara i ndihmojnë Kosovës të jetë sa më e përgatitur. "Përgatitjet kanë shkuar mirë. Kemi pasur edhe dy ndeshje miqësore me Sllovakinë, ku në ndeshjen e parë kemi mundur të fitojmë. Gjithsesi ndeshjet miqësore na shërbejnë të përgatitemi sa më mirë", ka thënë Azemi për faqen zyrtare të FBK-së.

Lidhur me gjasat e Kosovës për të arritur suksese në parakualifikimet e "Eurobasket 2021", Azemi ka pohuar se gjasat janë të mëdha për kualifikim dhe se Kosova është kundërshtarë shumë e fortë kur luan si vendëse. "Ndeshja e parë ndaj Luksemburgut në udhëtim është shumë e rëndësishme. Duhet të fitojmë dhe më pas e presim Britaninë e Madhe në Mitrovicë, ku presim 3 000 tifozë në palestër. Kemi treguar edhe më herët se në shtëpi jemi një 'arrë e fortë' për çdo kundërshtar. Britania ka lojtarë shumë të mirë dhe po cilësohet favorite, megjithatë ne nuk do të dorëzohemi dhe besoj se në shtëpi mund të mposhtim çdo kundërshtar. Besoj se edhe kemi gjasa të mira për kualifikim", ka thënë Azemi, i cili në muajin shtator mbush 39 vjet, por kjo nuk e pengon aspak që gjithmonë të japë maksimumin. "Jam rikthyer te Kosova dhe gjithmonë jap maksimumin. Si për Prishtinën ashtu edhe për Kosovën jap



gjithmonë 100 %. Edhe në këto parakualifikime shpresoj ta ndihmoj Kosovën që të kualifikohet më tutje", ka deklaruar basketbollisti i Prishtinës. "Dardanët" më 3 gusht janë mysafirë të

Luksemburgut, më pas e presin Britaninë e Madhe më 7 gusht dhe Luksemburgun më 14 gusht, kurse ndeshja e fundit është kundër Britanisë në udhëtim më 17 gusht.

Rahoveci kundër Clujit në FIBA Europe Cup

Në Munih të Gjermanisë është hedhur shorti për kualifikimet e FIBA Europe Cup. Nënkampioni i Kosovës, Rahoveci, do të përballet me Cluj Napoca e Rumanisë. Ndeshjen e parë 'Vrështarët' do ta zhvillojnë në shtëpi më 2 tetor, kurse takimi i kthimit zhvillohet pas një jave në Rumani. Kjo do të jetë hera e parë për Rahovecin që merr pjesë në një garë të nivelit të tillë. Kampionia e Kosovës, Z Mobile Prishtina, është në mesin e 15 skuadrave që, nëse kualifikohen në grupet e Basketball Champions League, do t'i bashkohet FIBA Europe Cup. Ndërkohë, 12 skuadra të tjera e kanë të siguruar pjesëmarrjen në grupe.

SHKURT

Erza Muminoviqi mposhtet nga Anna Kriza

Medalistja e bronzit olimpik për të rinj, Erza Muminoviq, garoi sot në garat e Festivalit Olimpik Evropian për të Rinj, Baku 2019. Xhudistja e Kosovës nuk e pati ditën e saj, pasi nuk arriti ta kalojë garuesen nga Hungaria, Anna Kriza, në raundin e parë të kategorisë -48 kilogramë. Edhe pse ishte në epërsi deri në sekondat e fundit, Erza u penalizua nga gjyqtarët me tri vërejtje.

Diellza Selaci përfundoi garat në 'Baku 2019'

Atletja Diellza Selaci mbylli garimin e saj në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Diellza garoi në 200 metra vrapim, me kohë 27.06 sekonda, që nuk i mjaftoi të kualifikohet tutje. Në baterinë e saj, ajo doli e gjashta.

Fejzullahu dhe Macula nuk kualifikohen tutje

Dy notaret e Kosovës, Hana Fejzullahu dhe Jona Macula, kanë vazhduar sot garat në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Jona garoi në 200 metra stil i lirë. Koha e saj ishte 2:23.63 që, sipas trajnerit të saj, Ardian Hamiti, e ka përmirësuar për 4 sekonda rekordin e saj personal, por që nuk i mjaftoi të kualifikohet tutje. Hana garoi në 100 metra bateri dhe pati kohën 1:09.30 sekonda, që ishte e pamjaftueshme për t'u kualifikuar tutje. Sporti i notit vazhdon garat edhe të enjten dhe të premten.

Drita shkon në Bullgari, përforcohet me Malokun

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita, ka udhëtuar për në Banskò të Bullgarisë për ta vazhduar fazën e dytë përgatitore. Gjatë qëndrimit dhjetëditorë klubi nga Gjilani ka paraparë t'i zhvillojë edhe tri ndeshje kontrolluese. Ndërsa ky klub e ka prezantuar edhe transferimin e ri, Faton Malokun. Ish-reprezentuesi i Kosovës ka luajtur në të kaluarën për Feronikelin dhe Gjilanin derisa ishte pjesë edhe e skuadrës së Kukësit.

Paraqitje e zbehtë e Kosovës ndaj Argjentinës

PRISHTINË, 24 KORRIK - Përfaqësuesja U21 e Kosovës në hendboll nuk ka pasur paraqitje të mirë të mërkurën në mëngjes në Kampionatin Botëror të Juniorëve në Spanjë. Në ndeshjen për plasman, Kosova ka humbur nga Argjentina me rezultat 36:29. Pas pjesës së parë rezultati ishte 18:13

për argjentinësit. Kosova vazhdimisht ka qenë në ndjekje të rezultatit, ndërsa epërsia e argjentinësve është rritur vazhdimisht. Përpjekjet e "Dardanëve" për ta barazuar rezultatit dhe për të kaluar në epërsi nuk ishin të suksesshme. Fare pak gjëra kanë funksionuar në lojën e

Kosovës. Kishte gabime teknike, gjuajtje që nuk përfunduan me gol e, po ashtu, lëshime në mbrojtje. Kjo ndeshje i shërben Kosovës vetëm si përvojë për ngjarjen e madhe ku Kosova garon për herë të parë. Tani Kosova U21 e ka edhe një ndeshje përfundimtare për plasman, të enjten ndaj Australisë.



Daku largohet nga Osijeku, prezantohet te Kukësi

KUKËS, 24 KORRIK - Skuadra e Kukësit ka arritur marrëveshje me sulmuesin Mirlind Daku. Anëtari i Përfaqësueses së Kosovës U21, skuadrës shqiptare i bashkohet në formë huazimi nga skuadra e

Osijekut. "Klubi njofton arritjen e marrëveshjes me ekipin kroat të Osijekut për futbollistin Mirlind Daku. Shtatlartijën në formë huazimi te skuadra jonë, me të drejtë blerjen e kartonit të tij. 21-

vjeçari, i cili mbron ngjyrat e 'Dardanëve' U21, ka luajtur me skuadrën e Hajvalisë dhe Llapit në Kosovë. Gjithashtu, Daku është aktivizuar në shtatë ndeshje me Kosovën U-21, ku është dhe autor i dy

golave. Futbollisti i datëlindjes 1998 luan si sulmues qendre dhe sezonin e shkuar u aktivizua 15 herë për Osijekun në Kroaci, duke shënuar dy gola", thuhet në njoftimin e Kukësit.



Kuka: Shteti nuk prezantohet me shëtitje dhe fotografi

PEJË, 24 KORRIK - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, është i zhgënjyer me sukseset e sportistëve të rinjve të Kosovës në Lojërat Evropiane që po mbahen në Baku. "Performancë e dobët e krejt sportistëve në të gjitha sportet, përfshirë edhe Erzen që llogaritej favorite për medalje. Kjo është alarmante se garuesit e rinj s'po ndërtohen si duhet në Kosovë. Për të tjerat sporte nuk e di, por për Erzen dhe disa garues të ekipit tim saktësisht e di shkaku dhe arsyen e paraqitjes shumë të dobët", ka thënë Kuka, i cili tregon se sporti kulminant kërkon jetë sportive 100 për qind. Trajneri Kuka ka shtuar se shteti nuk prezantohet vetëm me shëtitje dhe me fotografi, por me rezultate. "Prezantimi i shtetit do përgjegjësi e jo të shkohet në gara për shëtitje e fotografi. Deri në fund të EYOF ka ende garues. Të shpresojmë. Çdo federatë dhe trajner merrin përgjegjësitë e mos i bëni qejfe vetes se kryhet gara e çdo send harrohet. Këtu po përfshij edhe njerëz në stafin e trajnerëve në ekipin tim. Patjetër edhe unë dua t'i marr përgjegjësitë e mia", ka shtuar Kuka.



Honda në telashe, Lorenzo mungon edhe në dy garat e ardhshme

MADRID, 24 KORRIK - Spanjoli Jorge Lorenzo nuk do të marrë pjesë edhe në dy garat e radhës së Botërorit 2019 të Moto GP, ato të Çekisë dhe Austrisë. Piloti i Hondas, që nuk ka garuar edhe në Holandë e Gjermani, në dy garat e fundit të kampionatit ka konfirmuar se do të rikthehet në pistë më 25 gusht, në garën që do të zhvillohet në Angli (pista e Silverstone). Në Holandë, Lorenzo u dëmtua pas një rrëzimi në provat e lira dhe nuk mori pjesë në garë. Duket se ai nuk është ende gati, edhe pse aktualisht kampionati është pushim. Sipas Hondas, piloti spanjoll nuk ka rikuperuar ende 100 % nga dëmtimi dhe do të rikthehet në pistë vetëm pas një muaji. Në vend të tij do të pilotojë Stefan Bradl. "Ramë dakord të mos marr pjesë në dy garat e radhës, në Çeki



dhe Austri. Në këtë mënyrë do ta vijoj fazën e rikuperimit pas dëmtimit. Këtë periudhë të pushimit veror e kam kaluar duke punuar në palestër dhe gjendja fizike

është përmirësuar ndjeshëm. Gjithsesi, lëvizjet janë të limituara, ndaj nuk do të rrezikojmë dhe do të përgatitemi për rikthimin në Angli", ka deklaruar Lorenzo.

SHKURT

Istogu prezanton 7 futbollistë

Skuadra e Ligës së Parë, Istogu, pas marrëveshjes me trajnerin Valdet Shoshi, ka prezantuar plot shtatë futbollistë. Alban Haxhijaj, Ylli Buleshkaj, Leotrim Teplani, Dardan Podrimaj, Selim Bajramaj, Ragip Mazrekaj dhe Valmir Hajrizaj kanë përforcuar "Trofta"-t në këtë afat kalimtar. Klubi i Istogut po planifikon t'i transferojë të paktën edhe dy futbollistë të tjerë.

Allardyce: Maguire, i njëjtë me Van Dijkin

Trajneri Sam Allardyce ka thënë se Harry Maguire ka potencialin të bëhet aq i mirë sa Virgil van Dijk nëse kalon te Manchester Unitedi. Maguire ka qenë subjekt i spekulimeve për kalimin e tij te 'Djajtë e Kuq' në prag të fillimit të sezonit të ri. Një ofertë prej 90 milionë eurove thuhet se është pranuar nga Leicesteri, por marrëveshja ende nuk është finalizuar. "Ai është i ngjashëm me Van Dijkin, është shumë i mirë me topin dhe është i pakalueshëm. Van Dijku është përmirësuar që nga kalimi i tij te Liverpooli dhe të njëjtën e mendoj edhe për Maguire nëse shkon tek Unitedi", ka thënë Allardyce.

PSG-ja paguan 32 milionë euro për Gueyen

Kampionia e Francës, Paris Saint-Germain, e ka transferuar Idrissa Gueye nga Evertoni. Skuadra franceze do të paguajë 32 milionë euro dhe bonuset për 29-vjeçarin. Mesfushori nga Senegal ka luajtur edhe për Aston Villan dhe Lillen.

Asensio mungon 7 muaj

Një dëmtim i rëndë ka prishur atmosferën pozitive që mbizotëronte te Real Madridi para fillimit të sezonit të ri. Futbollisti i pafat është mëngjarashi Marco Asensio i cili pësoi një dëmtim të rëndë në gju në miqësoren kundër Arsenalit. Analizat mjekësore zbuluan shkallën e rëndë të dëmtimit. Këputje e ligamentit të kryqëzuar dhe traumë në menisk, dëmtime këto që duan mesatarisht 7 muaj kohë për t'u riaftësuar plotësisht.

Mund të bllokohet transferimi i Grizmannit te Barça

Atletico Madridit nuk i ka pëlqyer aspak mënyra se si Grizmanni dhe Barcelona arritën marrëveshjen. Sulmuesi e kishte deklaruar se do të largohej, mirëpo klauzola prej 200 milionë eurosh e francezit mund të pësonte një rënie vetëm prej 1 korrikut. Megjithatë, në pah dolën të dhëna se sulmuesi dhe Barcelona kishin akordin më parë dhe në këtë formë Barcelona duhej t'i paguante Atletico 200 milionë dhe jo 120 milionë euro. Në këtë mënyrë, madrilenët janë ndierë të ofenduar nga lojtari dhe klubi katalanas për marrëveshjen pas shpinës. Tashmë verdukuqtë kanë deklaruar se do ta ndjekin këtë çështje deri në fund për të marrë atë që iu takon. Kështu, presidenti i La Ligas, Javier Tebas, ka konfirmuar se Atletico ka kërkuar që ta bllokojë transferimin e Grizmannit dhe se diçka e tillë mund të ndodhë. "Atletico na ka shkruar duke na kërkuar ta bllokojmë transferimin e Grizmanit te Barcelona. Kjo është e mundur të bëhet. Mekanizmat janë vënë në punë dhe ata që gjykojnë mbi këto çështje do të duhet të marrin vendim për ta zgjidhur situatën. Por, unë nuk kam asnjë element gjykimi", ka thënë presidenti i La Ligas.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nr. 01-111-106654
Datë: 24.07.2019

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 3 i Rregullores Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Drejtoria për Inspektoratë

1. Titulli i pozitës së punës: Inspektor i Ujërave - INS/100

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)
Kategoria Funktionale: Niveli Profesional 3
Grada e vendit të punës: 8
Koeficienti: 7
Lloji i pozitës: Karrierës

Qëllimi i vendit të punës:

Brenda fushës specifike, kryen detyra profesionale dhe ofron shërbime në nivel ekspertit që kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të njësisë organizative.

Detyrat kryesore:

- Kontrullojë dhe konstatojë nëse shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave realizohet në përputhje me këtë ligj;
- Kontrullojë të gjitha punët e sistemit ujqor, ndërtimit të objekteve dhe të gjitha punëve të cilat mund të shkaktojnë ndryshime cilësore dhe sasore në regjimin ujqor,
- Kontrullojë rregullsinë e veprimit të objekteve mbrojtëse ujqore dhe objekteve për shfrytëzimin e ujërave,
- Kontrullojë rregullsinë e pajisjeve për përcaktimin e sasisë së ujërave të përdorura dhe ujërave të ndotura të shkarkuara,
- Urdhërojë shmangjen e mangësive të konstatuara gjatë kryerjes së mbikqyrjes dhe të caktoj afat për shmangjen e tyre,
- Urdhërojë ndërprerjen e ndërtimit të objekteve dhe impiantëve për të cilat nevojiten leje ujqore nëse objektet e tilla ndërtohen pa leje ujqore apo objekti ndërtohet në kundërshtim me kushtet e parapara në lejen ujqore.
- Ndalojë shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujërave nxerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit, hapjen e puseve si dhe aktivitetet dhe veprimtaritë tjera, të cilat ndikojnë mbi regjimin e ujërave apo mbi morfologjinë e trupit ujqor, nëse veprimtaritë dhe aktivitetet kryhen pa leje apo në kundërshtim me lejen.
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi;

Shkathësitë e kërkuara:

- Të ketë qasje konstruktive dhe kreative në zgjidhjen e problemeve të paraqitura gjatë realizimit të detyrave të punës duke marrë iniciativë të cilat kanë rezultuar shumë të suksesshme,
- Aftësi komunikuese, negociuese për zgjidhje të problemeve,
- Shkathësi në kaktim të objektivave, planifikim të punës, analizë të gjendjes dhe propozime për realizim të detyrave,
- Aftësi për të bashkëpunuar me grupe punuese,
- Aftësi për përmbushje të detyrave nën presion,
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve (Word, Excel, Power Point, Access),

Kushtet:

Diplomë Universitare, me titull Inxhinier i Ndërtimitarisë - drejtimi i Hidroteknikës dhe së paku 3 vite përvojë pune profesionale

Drejtoria për Arsim dhe Shkencë

1. Titulli i pozitës së punës: Zyrtar i lartë për standarde dhe vlerësim – AR/410

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)
Kategoria Funktionale: Niveli Profesional 3
Grada e vendit të punës: 8
Koeficienti: 8
Lloji i pozitës: Karrierës

Qëllimi i vendit të punës:

Hartimi, zhvillimi dhe mbikqyrja e zbatimit të legjislacionit, politikave, dhe dokumenteve tjera për procesin e monitorimit, vlerësimit dhe standardeve si dhe aftësimin profesional të mësimdhënësve në fushë e vlerësimeve.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Harton, zhvillon dhe mbikqyre zbatimin legjislacionit, politikave, procedurave dhe dokumenteve lidhur me procesin e monitorimit, vlerësimit dhe standardeve si dhe aftësimin profesional të mësimdhënësve në fushën e vlerësimeve;
- Zhvillon dokumente dhe metoda për monitorim dhe vlerësime praktike për krijimin e standardeve për proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies për të gjitha nivelet e shkollimit;
- Planifikon, koordinon dhe monitoron punën për zhvillimin e testeve dhe ndihmon në zgjidhjen e dilemave dhe arritjen e konsensusit mes anëtarëve të grupit apo anëtarëve të lëndëve gjatë procesit të zhvillimit të testeve;
- Përgatit dhe administron testet për arsimin parauniversitar dhe siguron trajnimin e drejtorëve të shkollave, inspektorëve dhe mësimdhënësve në përdorimin e testeve lëndore të standardizuara dhe përpunimin dhe interpretimin e arritjeve të nxënësve;
- Bashkëpunon me institucione ndërkombëtare në fushën e arsimit në mënyrë që praktikatat e mira për çështjet e vlerësimit të zbatohen në institucionet arsimore në Kosovë;
- Mbështet ekipin për zhvillimin e plan programeve në mënyrë që vlerësimi të bëhet pjesë përbërëse e procesit të plan programeve me qëllim të rritjes së efikasitetit në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi;

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
